



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 10-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.07.2022, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
9. Sami Bytyqi, anëtar
10. Fitim Shala, anëtar
11. Xhyzide Rustemi, anëtare
12. Rinor Murati, anëtar
13. Armend Grajqevci, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Gentianë Hoxhaj, anëtare
16. Venhar Agushi, anëtar
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragacina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Anila Reçica, DKRS
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Flamur Sylejamni, DI
8. Elmaze Behluli, DA
9. Sead Aliu, DI
10. Rexhep Rexhepi, DBP
11. Rasim Hasani, DA
12. Safete Amerrlahu, DGJK
13. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 9-të e Kuvendit
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2022.
3. Propozim vendim për emërtimin e Qendrës Kryesor të Mjekësisë Familjare në Lipjan.
4. Propozim Vendim për formimin e komisionit komunal për rishqyrtimin e emërimeve dhe riemërimeve të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.
5. Propozim vendim për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2022.
6. Propozim Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 15nr.463-76605 të datës 26.12.2018.

Po ashtu tha se do ta kemi edhe një pikë shtesë ashtu siç ju kemi njoftuar me email e të cilën e kemi hiq në seancën e kaluar , po ashtu kjo pikë e ka marrë edhe rekomandimin e KPF-së

7. Propozim Vendim mbi rialokimin e mjeteve për vitin 2022

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës të propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se para se me kaluar te pyetjet e anëtarëve të kuvendit ju uroj për marrjen e llaptopëve, i gëzofshi. Dhe ashtu siç jemi dakorduar , momentin që anëtarët e kuvendit do t'i kenë llaptopët ashtu siç ka qenë kërkesa, materialin në mënyrë fizike tani më nuk do ta shpërndajmë, kështu ka qenë dakordimi. Dhe tash e tutje materialin e kuvendit do ta merrni vetëm në mënyrë elektronike., duke i respektuar afatet ligjore të caktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Uroj që këta laptop të na shërbejnë për punë të mira për komunën tonë.

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Egzona Bytyqi, tha se pasi që pandemia covid 19 ende nuk ka përfunduar dhe vazhdimisht po regjistrohen raste të reja me këtë sëmundje infektive. Kërkoj një informatë nga drejtori i shëndetësisë lidhur me situatën aktuale pandemike,në komunën tonë. Sa është numri aktiv i të sëmurëve me covid. Sa është numri i testeve rapide që po realizohet. Cilat janë kapacitetet infrastrukturore shëndetësore që ne i kemi aktualisht qoftë me personel apo përmes barnave esenciale. Sa është numri aktual i të vaksinuarve në komunën tonë? Po ashtu unë e kam një vërejtje sa i përket faqes elektronike të komunës, pasi qe nuk kemi asnjë informatë rreth këtyre qe i thash deri me tani. Nuk kemi asnjë promovim në faqën zyrtare të komunës. Kur pritet të filloj dezinfektimi i hapësirave publike të cilat i kemi?

Albiona Tasholli,tha se kam një shqetësim për ta ngritur lidhur me mjetet lëvizëse si motoçikletat dhe trotinetët elektronik, si dhe mjete tjera të ngjashme po lëvizin nëpër shesh me një lëvizje të pa kontrolluar. Andaj për parandalimin e ndonjë dëmi eventual kërkoj që të ndalohen ngasja e këtyre mjeteve nëpër shesh,pasi qe sheshi është hapësirë e destinuar vetëm për këmbësorë.

Armend Grajqevci, tha kam një pyetje për DKA-në lidhur me shkollën “Adem Gllavica” në Lipjan ,punimet të cilat janë duke u zhvilluar aty deri ku kanë shkuar. Po ashtu a është e përfshirë komuna e Lipjanit në ndërtimin e disa çerdheve publike që do të ndërtohen nga Qeveria e Kosovës, ose ndonjë projekt tjetër infrastrukturor?

Arsim Jashari, tha se unë i kam dy kërkesa nga qytetarët,e para ka të bëjë me Drejtoratin e shërbimeve publike lidhur me fontanën e ndërtuar në shesh e cila nuk po funksionon, ku është problemi, do të ishte mirë atë fontanë me funksionalizuar? Çështja e dytë ka të bëjë me banorët të cilët banojnë prapa hekurudhës të cilët po e

kalojnë në këmbë atë pjesë e po kanë problem, sipas qytetarëve aty ka një petition për një nënkalim. Çështja e tjetër po ashtu ka të bëjë me të njëjtën lagje ku aty afër Golden Dey, po parkohen veturat dhe po bllokohet rruga për kalim të qytetarëve dhe me atë po rrezikohen qytetarët . Dhe çështja e fundit ka të bëjë me rregullimin e kanalizimit përballë autoshkollës” Ari” kur pritet me u kyç në rrjet. Dhe e fundit ju falënderojmë për dhurimin e llaptopëve pasi që me këtë do të ju lehtësohet puna edhe juve edhe neve, dhe çdo punë të mirë do ta përkrahim

Bashkim Budakova, tha se edhe unë e kam një shqetësim të njëjtë sikurse parafolësja Albiona lidhur me shqetësimin e qytetarëve, trotinetet elektronik a kanë leje për kryerjen e kësaj veprimtarie apo veprojnë ilegalisht, në bazë të cilit kriter këto veprimtari po funksionojnë?

Lulzim Rustemi, tha se kam disa pyetje e para, çka po bëhet me asfaltimin e rrugicave të cilat janë zhavoruar a është ndërmarrë ndonjë hap prej çeverisë apo prej komunës, a ka ndonjë lëvizje në këtë drejtim? E dyta për kryetarin a keni kontakte me Deputetët e Kuvendit të Kosovës nga Lipjani, që projektet që janë për Lipjanin të ecin përpara. Është një shembull i mirë kryetari i komunës së Ferizajt ku ka biseduar me deputetet për projektet dhe të mirën e qytetarëve të Ferizajt. Është mirë me pas një urë komunikimi me deputetet e Lipjanit.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, çështja e trotinetëve është dukuri që e kam vërejt por nuk kemi rregullativë me të cilën duhet t'i kërkojmë leje. I njëjti shqetësim është edhe me shitësit ambulantë jemi para një situatë jo të lehtë të mundshme. Është angazhuar inspektorati për këtë punë dhe ju kam kërkuar që të përdoren mekanizma vetëm për ato të cilat janë të dëmshme. Kërkoj nga drejtori përkatës që në mbrëmje mos të lejohen në shesh këto, të kalojnë te shtegu i biçikletave. Shkolla e mesme “Adem Gllavica” ka filluar punimet që 5 vite dhe cila çeveria që po vjen po e heq nga buxheti. Tani e kanë shti për 5 vite nga pak. Për këtë buxhet nuk ka asnjë projekt për komunën tone, ndërsa për vitin e ardhshëm nuk e di a do të ketë ndonjë projekt. Nuk kemi asnjë çerdhe as asgjë tjetër për komunën tonë. Te fontana i ka skaduar garancioni kompanisë, ndërsa kjo nuk është paraparë në kontratën e mirëmbajtjes. Kemi shumë rrugë të cilat kanë mbetë në gjysmë për shkak të rritjes së çmimeve, dhe po presin subvencione nga çeveria. Unë i kam dërguar disa shkresa një ministri dhe kam kërkuar takim që 6 muaj dhe skam marrë përgjigje. Unë nuk pres me më ndihmuar kushdo që është nalt në qeveri, por pres mos me më pengu në zhvillimin e komunës sonë.

Shkelzen Hajdini, tha se sipas IKSHIP-së numri aktiv i të infektuarve në komunën e Lipjanit është 452, i të infektuarve për këtë muaj 631, numri i testimeve 1666, numri i të vaksinuarve total mbi 61915. Web faqen e QKMF-së jemi duke e aktivizuar vetëm se jemi duke e testuar. Ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet për pandeminë covid 19 , dhe jemi duke e menaxhuar në mënyrën me të mirë dhe i kemi marrë të gjitha masat. Kemi rritë numrin e testimeve në laborator.

Arsim Jashari, tha e përgëzoj drejtorin për masat që ka marrë për largimin e veturave te Golden Dey

Pasi qe çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e IV-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nexhmedin Lekiqi, tha se kam një vërejtje, askund nuk e kam cek që mos të ndërtohen çerdhet,por të subvencionohen çerdhet private.

Daut Azemi, tha se edhe ne duhet me pas pak konsiderate se nganjëherë po flasim shumë shpejtë dhe nuk po mundet krejt me i përcjellë procesmbajtësi. Por gabimet që i vëreni mund të rregullohen.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga mbledhja e IV e Kuvendit, me vërejtjet e cekura me lartë, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 29 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja IV-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II.

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i'a dha fjalën, Latif Ramadani, DBF,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se një pikë e rëndësishme, është një fazë mjaftë e ndishme por shpenzimet ende janë të vogla, por shpresojë që do të ketë një dinamikë tjetër. Te buxheti i alokuar kemi shpenzim të vogël, po ashtu edhe te investimet kapitale kemi shpenzim të vogël dhe brengosëse edhe pse ndoshta ka ndikuar edhe rritja e çmimeve. Te granati qeveritar te buxheti, te investimet kapitale, prapë një shifër e vogël. Te të hyrat vetanake të bartura edhe këtu shfrytëzim zero. Buxheti Sipas fondeve burimore te disa drejtori është jashtëzakonisht i vogël. Të hyrat vetanake të bartura edhe këtu shumë keq. Investimet kapitale po ashtu shpenzimet zero. Në shëndetësi ende nuk kemi filluar me investime dhe nuk ka ende shpenzim. Te Arsimi e kemi po ashtu gjendjen e njëjtë shpenzim shumë të vogël. Te shërbimet tjera kontraktuale kam kërkuar që të detalizohen, mbeten që në të ardhmen të detalizohen dhe të pasqyrohen sakte se ku kanë shkuar. Ky raport ka një shpenzim të vogël dhe duhet një trusni në nivel qendror. Presim që të kemi suksese por deri tani shpenzimet janë të vogla.

Besiana Syla, tha se siç po shihet nga raporti buxheti i alokuar është mbete prapë i njëjt nuk është ndryshuar, çka nuk paraqet gjendjen faktike, për arsye se nuk është buxhet i disponueshëm, andaj vërejtja e më parshme që e kam dhënë në raport nuk janë marrë parasysh, prandaj po e përsërisë nuk është buxhet i alokuar por buxhet i miratuar. Nga raporti siç po shihet kemi buxhet të vogël të shpenzuar. Ajo çka është brengosëse është te shpenzimet te investimet kapitale ku shpenzimi është 11%. Unë e inkurajoj kryetarin për donacionin, por ky do të kishte efekt vetëm nëse nuk do të shkonte suficit. Te investimet kapitale me krahasuar me vitin e kaluar jemi shumë më keq. Nga buxheti i alokuar kemi buxhet të kënaqshëm.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se raportin duhet trajtuar gjithanshëm dhe specifikisht, jemi të vëdijshtëm për situatën. Le të na tregojë parafolësja se cila është mesatarja. Pengesa kemi pas të vazhdueshme. Të hyrat vetanake barten nuk humbin. Këtu nuk ka asnjë shifër të fshehur të gjitha janë reale. Nuk kemi rishikim të buxhetit vetëm ridestinin. Na me DEMOS, i kemi fituar 1 milion, por aty i kemi vetëm gjysmën por na kane blloku, që me thënë që ju kanë shkuar suficit, ku janë mjetet tjera. Me të hyrat vetanake qëndrojmë mirë, dhe i falënderoj qytetarët e komunës së Lipjanit.

Besiana Syla, tha se me sa e di unë mesatarja e shpenzimit të buxhetit duhet me kanë mbi 45%. Unë po flas vetëm në bazë të raportit. Nëse unë e jap një kritike

merre si pozitive, na jemi për kritika për këshilla propozime, dhe kështu do të na keni për 4 vite.

Lulzim Rrustemi, tha se e harrova me sekt te fondet burimore sipas kategorive ekonomike, te shërbimet publike, por nuk po figuron drejtorati për infrastrukturë, a është buxheti i njëjtë, për këtë deshta me pyet?

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, departamenti i infrastrukturës është nga janari, ndërsa ky raport është nga viti i kaluar.

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

III

Propozim vendim për emërtimin e Qendrës Kryesor të Mjekësisë Familjare në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i'a dha fjalën, Shkelzen Hajdini DSH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj kryesuesi, hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se ne si grup i LDK-së, e përkrahim fuqishëm propozim vendimin për emërimin e QKMF-së në Lipjan me emrin e të ndjerit Dr. Mehdi Zejnullahu, ku figura e dr Mejdiut është ombrellë me të cilën ne mjekët ndihemi krenar, sidomos kur flasim për një student të dalluar të gjeneratës, po ashtu pa lodhshëm ju përgjigj ndihmës se qytetarëve. Po ashtu një kolege dhe një mentor shume i dashur.

Alban Salihu, tha se ky propozim është vazhdimësi i qeverisjes lokale për përvetësimin e çdo institucioni publik, njejt sikur po tentoni të bëni me QKMF-në. Në shumë raste keni vepruar edhe me emërtime të rrugëve të institucioneve të ndryshme publike e të tjera. Me këtë qasje i keni pezulluar edhe zgjedhjet e këshillave të fshatrave, për shkak se nuk mund t'i zgjidhni njerëzit tuaj. Ne konsiderojmë se për vendime të tilla sikur ky për QKMF-në duhet të ketë debate të hapura e gjithëpërfshirëse , të vendosen kritere të qarta për kontributin e secilit. Kjo pikë do të duhet të largoj nga rendi i ditës dhe të bëhet debat më i gjerë.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, çdo peticion i cili i drejtohet kryetarit të komunës duhet të trajtohet, nëse mendoni që ta mbaj në sirtar e mos ta bie në kuvend e keni gabim , nëse e keni menduar që unë do ta emëroj dikë vet prapë e

keni gabim, sepse nuk është përgjegjësi e kryetarit të bëjë emërtime. Por, të konstatosh që po përvetëson emra, nuk e pranoj. Ku kemi përvetësuar emra, cilin institucion e kemi përvetësuar? Asnjë emërtim që 9 vite se kam sjellur në Kuvend. I kam vendos përmendoret e dëshmorëve, i mirëmbaje të gjitha varrezat në komunën e Lipjanit. Nuk ka pas asnjë propozim tjetër deri me tani? Me këtë nuk po e madhërojmë atë doktor, po e madhërojmë të gjithë atë ekip që ka punuar në kohën e luftës për të mirën e qytetarëve. Kërkoj nga ana juaj që mos të bëjmë debat e mos të politizojmë kot, por të votojmë këtë propozim.

Arsim Jashari, tha se kuvendni është organi me i lartë, vijnë peticionet por ne jemi ata të cilët e marrim vendimin . me një propozim po e involovojmë familjen, pasi që historia duhet të tregohet drejtë. Askush nuk është kundër doktorit as kundër familjes së tij, por është dashtë me ardh disa propozime. Edhe propozimi i shoqatave ka mujtë me ardhe si pikë e rendit të ditës edhe pse ka ardhe me vonesë, se kur po keni naj pikë shtesë me shti në kuvend po e shtini, keni mujt edhe këtë pikë me shti, pavarësisht a ka qenë politike ose jo. Kish qenë mirë me bërë një debat të gjërë me të gjithë, dhe të bëjmë zgjidhjen me të mirë. Ne si grup i PDK-së nuk do ta përkrahim këtë propozim vendim, pse mos t'i emërojmë mjekët e luftës të cilët kanë kontribuar shumë, në mesin e tyre e kemi edhe dr Nexhin. Ose ta lojme siç ka qenë që sa vite QKMF në Lipjan. Ta shtyjme këtë pikë dhe të vijnë disa propozime dhe të vendosim për më të mirin.

Nexhmedin Lekiqi, tha se para vetës kemi një propozim për emërimin e QKMF-së, emrin një doktori, e me këtë nuk do ta nderojmë vetëm doktorin por të gjithë doktorët. Doktori nuk dallon nga ushtari, pasi edhe doktori ka dhënë kontribut dhe na nuk duhet me pas frikë nga emri i një mjeku. Kontributi i këtij doktori është i madh dhe e meriton emrin e tij QKMF-ja, pasi që na nderon të gjithëve.

Arsim Jashari, tha se askush nuk ke kundër doktorit as nuk e mohoj askush kontributin që e ka dhënë, ne po flasim për emërtim, jo për kontribut. Na po mendojmë që nuk është i duhuri për këtë institucion, Hajde ta shtyjme këtë pikë, ose në të kundërtën ne si grup do ta lëshojmë sallën.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se jam hisedar i asaj periudhe të luftës dhe pas luftës me aktivist të mëdhenj të asaj kohe, ne mesin e tyre edhe dr Mejdiu dhe meritat e tij nuk mundet me i marrë askush. A kemi pas ndonjë emër të propozuar më herët, te ndonjë doktori, jo, dhe unë nuk mund t'i injoroj 174 nënshkrimet e stafit shëndetësor. Ne kemi ditë të bëjmë kompromise dhe ju ftoj të

gjithë unanimisht ta votoni, këtë propozim pasi që ky doktor ju ka shërbyer qytetarëve të komunës sonë por edhe familjarëve tanë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se na që punojmë në shëndetësi kemi përshtypjet më të mira për dr Mehdiun, ku ka qenë një bashkëpunëtor i ngushtë si kryetar i sindikatës. Megjithatë unë kam vërejtje në këtë propozim për proceduarat që janë ndjek, ku thuhet që personeli shëndetësor në Magurë kanë marr iniciativën për emërimin e QKMF-së, ata mundën me marr initiative për ne Magurë, mirëpo jo për QKMF-në në Lipjan. Dhe procedurat do të duhej të fillojnë nga bordi, e ai bord me formuar një komision që do të përbehej nga emra të cilët e dinë mirë historikun e QKMF-së në Lipjan .Ai komision pastaj me ju drejtuar bordit e pastaj bordi juve. Çka nëse në te ardhmen QMF në Gadime me kërkuar me ndryshuar emrin. Tjetra po me intereson a i ka verifikuar dikush ato nënshkrime. Po ashtu pse nuk e kemi mendimin e komitetit për shëndetësi.

Daut Azemi, kryesues, komiteti i shëndetësisë dje mbajtë takim, por komiteti mban takime për shëndetësi e jo për emërtime.

Bashkim Budakova tha se sa i përket këtij propozimi nuk dua të paragjykoj për mjekun, por ajo që është ardhë në biografi është e paktë. Do të ishte mirë që të kemi më shumë propozime dhe ne do ta zgjidhnim atë që është më e miri, dhe vetëm një propozim është imponim.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës tha se,na nuk ja kenë shkruar historinë, se historinë e shkruajnë vet doktori historiani,ushtari, por thuaj se votoj mos e voto.

Lulzim Rrustemi, tha një propozim i rëndësishëm, vetëm që është mirë anëtarët e kuvendit me biseduar qetë, pa emocione ,arsyeshëm dhe me këtë do ta ndjekim më të mirën për qytetarët. Personeli shëndetësor i ka ndjek proceduar i ka pru nënshkrimet, por me i pas pru disa aletrnativa tjera sa nënshkrime i kishin marrë. QKMF-nuk është vetëm e personelit shëndetësor por e të gjithë qytatarëve të komunës së Lipjanit. Duhet të këtë propozime tjera, ne si grup nuk e përkrahim këtë propozim vendim. Sipas neve kjo nuk i ka kredencialet per et qenë emërtim në QKMF.Pasi që komuna jonë ka shumë emra me kretibilitet, ka njerëz që i kanë qëndruar kohës.Kjo pikë duhet të shtyhet dhe të këtë debat më të gjërë pasi që ka shumë njerëz që e meritojnë dhe ta marrim vendim meritör.

Daut Azemi, secili i bartë pasojat për votën e vet, dhe mos i merrni përgjegjësite e të tjerëve.

Arsim Jashari, tha unë po them që ky emër nuk është i denjë për atë pozitë, dhe ne nuk do ta përkrahim.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi e vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për prezentë, aprovoi vendimin.

Pastaj kryesuesi dha pauzë nga ora 12:10 deri në ora 14:00

IV

Propozim Vendim për formimin e komisionit komunal për rishqyrtimin e emërimeve dhe riemërimeve të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Semetishti DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Fitim Shala, tha se në emër të grupit të LDK-së për anëtarë të komisionit i propozojmë, Dr Nexhmedin Lekiqin dhe Dr Gazmend Qerkinin.

Arsim Jashari, tha se në emër të grupit të PDK-së e propozojmë Ardit Canin.

Alban Salihu tha se në emër të Grupi të LVV-së e propozojmë Fatmir Fetahun.

Lulzim Rrsutemi,tha se te afati është mirë mu precizuar deri në fund të vitit 2023

Daut Azedmi, aty ku nuk janë zgjedhur kryetarët e këshillave e vazhdojnë ata aktualët.

Imri Semetishti, nuk prish punë edhe nëse e bëjmë deri në fund të vitit 2023, por neve na ka obliguar Agjencioni Kadastral me i kryer sa më shpejtë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha,se me ndryshimin që titulli të jetë Komisioni për emërimin e rrugëve të reja , shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërimin e rrugëve në territorin e komunës së Lipjanit dhe te Afati kohor për përfundimin e punëve është më së largu deri në fund të vitit 2023

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimet e cekura me lart, dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi Vendim për formimin e Komisionit të aksionarëve.

V

Propozim vendim për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdini ,DSH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi Vendim për formimin e Komisionit të aksionarëve.

VI

Propozim Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 15nr.463-76605 të datës 26.12.2018.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Semetishtit , drejtor i DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se një propozim që po zgjat që disa vite por po shpresojmë që me këtë afat që është cek do të përfundoj kjo punë. Pasi që objektet aty të vjetra ende po qëndrojnë dhe është bllokuar ndërtimi i sheshit, dhe mos me mbet na peng i atyre pronarëve, pasi që zgjatja me së shumti po ju shkon dëm qytetarëve dhe komunës. Dhe shpresojmë që të jetë sa me e kujdesshme komuna dhe drejtorati i urbanizmit që kjo të kryhet sa më shpejtë.

Daut Azemi, komuna do t'i marr masat që me ja ofruar kushtet atyre, pastaj do të merren edhe masat.

Lumturije Bytqi,-Hasani, tha se kur ka ardh ky propozim në kuvend ne vitin 2018 të gjithë u patëm gëzuar,pasi që kemi shpresuar që do të kemi një pamje më të

bukur të asaj pjese, e që fatkeqësi është shëmtuar ajo pjese. Atëherë ka pas një dakordim të banorëve, ndërsa tash nuk ka dakordim, dhe unë do te votoj kundër për shkak se investuesit nuk janë treguar serioz.

Imri Semetishti, tha se sipas drejtoratit të urbanizimit do të jetë afati i fundit, ku do t'i caktohen edhe kushtet e ndërtimit, nga ana jonë, në të kundërtën do ta humb të drejtën e tij.

Arsim Jashari, tha se ata qytetarë banesat i kanë bërë lokale, dhe kontratat kur i kanë bërë i kanë bërë për banesë, ndërsa kompensimin po e kërkojnë për lokale.

Daut Azemi, aty ka pas marrëveshje mes banorëve dhe punëkrysit . Por na do të ja caktojmë kushtet dhe tani ineqsitori e ka afatin e caktuar për ndërtim.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, 2 kundër, 3 abstenime aprovoi Vendim për formimin e Komisionit të aksionarëve.

VII

Propozim Vendim mbi rialokimin e mjeteve per vitin 2022

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit , drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Ardit Cani, tha se kërkoj qe në ridestitim të futet edhe asfaltimi i rrugicave në fshatin Bainsë , për shkak që i pamundësohet lëvizja një personi invalidor.

Armend Grajqevci, tha se e përgëzojmë drejtoratin për të hyrat dhe si grup i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.

Latif Ramadani, tha se, tha këtu do te përfshihen ato projekte qe kane mbet ne gjysme.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se projekte që janë në fshatra është mirë me u kthyer në të njëjtin fshat e jo të shkojnë në një vend tjetër siç është rasti i lumit në fshatin Sllovi, dhe ai lum duhet te përfundoj se është në gjendje të keqe.

Latif Ramadani, me mbetje ne nuk mundemi me garantu që do të kryhet lumi në Sllovi

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se muaji Gusht do të jetë muaj i pushimeve, vetëm nëse kemi ndonjë seancë të jashtëzakonshme.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi Vendim për formimin e Komisionit të aksionarëve.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,55

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi